

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit te
Pavarur

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE Sh.p.k

31 Dhjetor 2012

Permbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit te Pavarur	1
Bilanci kontabel	3
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve	4
Pasqyra e ndryshimeve te kapitalit	5
Pasqyra e flukseve monetare	6
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare	7

Raporti i Audituesit te Pavarur

Per drejtuesit dhe Ortakun e,

Regjistri i Barreve Siguruese sh.p.k

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te bashkangjitura ketij raporti te Regjistri i Barreve Siguruese sh.p.k ("ketej e tutje referuar si "Shoqeria") qe perfshijne bilancin kontabel me 31 Dhjetor 2012 dhe pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e ndryshimeve te kapitalit dhe pasqyren e flukseve monetare per vitin ushtrimor, si dhe nje permbledhje te politikave te rendesishme kontabel dhe shenime te tjera shpjeguese, te paraqitura ne faqet 7 deri 15.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegies per pregatitjen dhe prezantimin e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe politikat kontabel ne vend, dhe per kontrollin e brendshme qe drejtimi i konsideron te nevojshme per pregatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, qofte nga gabimet apo mashtrimet.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Ne kemi kryer auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te perftuar siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidence auditimi ne lidhje me vlerat dhe pohimet ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke perfshire vleresimin e rrezikut te anomalive materiale te pasqyrave financiare, si rezultat i gabimit apo mashtrimit. Gjate vleresimit te rrezikut audituesi konsideron kontrollin e brendshem te pershtatshem per pregatitjen e drejte te pasqyrave financiare te Shoqerise me qellim qe te planifikojte procedura auditimi qe jane te pershtatshme me rrethanat, por jo me qellim per te shprehur nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te Shoqerise. Nje auditim gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdorura dhe pershtatshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe vleresimin e pergjithshem te paraqitjes se pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te siguruar bazat per opinionin tone te auditimit.

Opinion

Ne opinionin tone, pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te drejte, ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te Shoqerise me 31 Dhjetor 2012, si dhe performancen financiare dhe flukset monetare per vitin ushtrimor, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Tirane, 15 Mars 2013

Alfred Sefa


Ekspert Kontabel i Regjistruar



Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Bilanci kontabel

	Shenime	2012	Leke Me 31 Dhjetor 2011
Aktivet			
Mjete monetare	3	10,305,688	11,689,213
Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	4	72,522,248	31,300,000
Aktive afatgjata materiale, neto	5	4,174,769	5,048,948
Totali aktiveve		87,002,705	48,038,161
Kapitali dhe detyrimet			
Detyrimet			
Llogari te pagueshme dhe te tjera detyrime	6	6,806,383	2,984,111
Tatimi mbi fitimin	7	618,359	3,873,496
		7,424,742	6,857,607
Kapitali			
Kapitali themeltar		6,200,000	6,200,000
Rezerva ligjore		59,629	59,629
Fitime te pashperndara		-	-
Fitimi ushtrimor		73,318,334	34,920,925
	8	79,577,963	41,180,554
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		87,002,705	48,038,161

Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga drejtimi i Shoqerise me 12 shkurt 2013.
Nenshkruar ne emer te saj nga,

Znj. Brunilda Jegeni
Administratore

Znj. Dorina Omeri
Financiere



Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

Shitjet	Shenime	Leke	
		Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2012	2011
Totali i te ardhurave	9	108,710,878	58,800,748
Shpenzime personeli	10	(15,150,275)	(11,419,787)
Amortizimi dhe zhvleresimi	5	(1,063,836)	(1,288,805)
Te tjera shpenzime	11	(10,987,577)	(7,215,057)
Fitimi operacional		81,509,190	38,877,099
(Humbje) / fitim nga kursi kembimit,neto		-	(66,000)
Te ardhura/(Shpenzime) te tjera financiare, neto		5,257	3,323
Fitimi para tatimit		81,514,447	38,814,422
Shpenzim tatim mbi fitimin	12	(8,196,113)	(3,893,497)
Fitimi neto per vitin		73,318,334	34,920,925



Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e ndryshimeve te kapitalit

	Kapitali themeltar Leke	Rezerva ligjore Leke	Fitimet e pashperndara Leke	Totali Leke
Gjendja me 01 Janar 2011	100,000	10,000	6,149,629	6,259,629
Kapitalizimi i fitimit	6,100,000	49,629	(6,149,629)	-
Fitimi i periudhes	-	-	34,920,925	34,920,925
Gjendja me 31 Dhjetor 2011	6,200,000	59,629	34,920,925	41,180,554
Gjendja me 01 Janar 2012	6,200,000	59,629	34,920,925	41,180,554
Divident	-	-	(34,920,925)	(34,920,925)
Fitimi periudhes	-	-	73,318,334	73,318,334
Gjendja me 31 Dhjetor 2011	6,200,000	59,629	73,318,334	79,577,963



Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e flukseve monetare

Shenime	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor	
	2012 Leke	2011 Leke
Fitimi neto para tatimit	81,514,447	38,814,422
Rregullime per zerat jo monetare ne fitimin para tatimit:		
Amortizimi dhe zhvleresimi	5 1,063,836	1,288,805
Te (ardhura) nga interesi	(5,257)	(3,323)
Fitimi operativ perpara ndryshimeve ne kapitalin punues	82,573,026	40,099,904
<i>Ndryshimet ne kapitalin punues:</i>		
Ndryshimin ne llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme	4 (41,222,248)	(31,300,000)
Ndryshimi ne llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime	6 3,822,276	(1,489,865)
Interes i arketuar	5,257	3,323
Tatim fitimi i paguar	12 (11,451,250)	(566,124)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktiviteti operativ	33,727,061	6,747,238
Aktiviteti investues		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	5 (189,657)	(78,638)
Mjetet monetare neto (te perdorura) ne aktivitetin investues	(189,657)	(78,638)
Aktiviteti financues		
Mjetet monetare neto (te perdorura) ne aktivitetin financues		
Dividentet e paguar	(34,920,927)	-
Ndryshimi neto ne mjetet monetare	(1,383,523)	6,668,600
Mjete monetare ne fillim,te periudhes	11,689,211	5,020,611
Mjete monetare ne fund te periudhes	10,305,688	11,689,211



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

1 Informacion i pergjithshem

Regjistri i Barreve Siguruese sh.p.k (“Shoqeria”) eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar ne prill te vitit 2009 dhe rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit

Selia qendrore e shoqerise eshte ne adresen Rr. Dibres Qendra e Biznesit A.K. Selvia kati 4 , Tirane. Ajo eshte regjistruar si person i tatueshem ne rrethin e Tiranës me numër identifikimi të personit të tatueshëm (NIPT) K91627014G.

Aktiviteti kryesor i shoqerise eshte: Kryerja e veprimtarise se mbajtjes, ruajtjes, kryerjes se te gjitha veprimeve ne lidhje me Regjistrin e Barave Siguruese te parashikuara nga ligji Nr. 8537, i ndryshuar .

Administratori i shoqerise eshte Znj. Brunilda Jegeni. Me 31 Dhjetor 2012 shoqeria ka 8 punonjes (31 Dhjetor 2011: 7 punonjes).

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012 jane aprovuar nga administratori 12 Shkurt 2013.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 6,200,000 leke . Kjo shume ka ardhur nga kontributi i ortakut ne momentin e rregjistrimit prej 100,000 dhe kapitalizimit te fitimeve te realizuar prej 6,100,000 ne korrik 2011.

Me 31 dhjetor 2012 sipas regjistrimit tregtar ne QKR struktura e kapitali paraqitet si vijon:

	2012	2011
ROEN Company (kapitali themeltar) 100%	6,200,000	6,200,000



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

2 Politikat kontabel

Politikat kryesore kontabel te adoptuara per pregatitjen e ketyre pasqyrave financiare paraqiten si me poshte. Keto politika jane zbatuar ne menyre konsistente ne te gjithe vitet e paraqitura, pervec kur percaktohet ndryshe.

2.1 Bazat e pregatitjes

Pasqyrat financiare jane pregatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te perfshira ne ligjin Nr 9228 date 29 Prill 2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ndryshuar me ligjin Nr 9477 date 09.02.2006 dhe me urdhrin e Ministrit te Financave Nr 65 date 5.05.2008.

Keto pasqyra financiare jane pregatitur bazuar ne parimin e kostos historike parimin e biznesit ne vijimesi dhe parimit te te drejtave te konstatuara.

Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane te shprehura ne Leke, qe eshte monedha raportuese e shoqerise. Disa riklasifikime jane bere te nevojshme per vlerat krahasuese per te qene konform prezantimit te vitit aktual.

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel

a) Monedhat e huaja

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Zerat e perfshire ne pasqyrat financiare te Shoqerise maten duke perdorur monedhen e mjedisit kryesor ekonomik ne te cilin entiteti operon (monedha funksionale). Pasqyrat financiare jane paraqitur ne Leke, e cila eshte monedha e prezantimit te Shoqerise.

Transaksionet dhe gjendjet

Ne pregatitjen e pasqyrave financiare te Shoqerise, transaksionet ne monedha te ndryshme krahasuar me monedhen funksionale te Shoqerise (monedhat e huaja) rregjistrohen me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Ne cdo date te Pasqyres se pozicionit financiar, aktivet dhe detyrimet monetare qe jane ne monedha te huaj perkthehen me kursin e kembimit te dates se Pasqyres se pozicionit financiar. Diferencat nga kembimi njihen ne fitim ose humbje ne periudhen ne te cilen lindin.

b) Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te hyjne ne Shoqeri ne te ardhmen, dhe qe te ardhurat mund te maten ne menyre te besueshme. Te ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit te te drejtave te konstatuara. Te ardhurat nga shitja njihen kur i jane kaluar blerësit te gjitha rreziqet dhe perfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftueshme ne marrjen e perfitimeve. Te ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit.

Te ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose zbritjet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe kur realizohen te ardhurat per te cilat jane kryer keto shpenzime.

Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin kur ato ndodhin sipas parimit te te drejtave te konstatuara dhe kontabilitetit rrjedhës.



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

a) Tatimet*Tatimi mbi fitimin*

Aktivi dhe detyrimet per tatimin mbi fitimin per periudhen aktuale maten me shumate e pritura per tu mare nga apo per tu paguar tek organet tatimore. Norma e tatimit dhe ligjet per tatimet te perdorura per llogaritjen e vleres se tatim fitimit, jane ato te nxjerra ose te publikuara ne daten e raportimit ne Shqiperi, ku Shoqeria operon dhe siguron te ardhura te tatueshme.

Drejtimi vlereson ne menyre periodike pozicionet e ndermarra ne formularet e deklarimit te pagesave ne lidhje me situata ne te cilat rregulloret e aplikueshme per tatimet jane subjekt i interpretimeve, si dhe nje provizione nese eshte e pershtatshme.

Tatim fitimi llogaritet me 10% (31.12.11: 10%) mbi fitimin e tatueshem

Tatimi fitimi i shtyre

Shoqeria nuk ka zgjedhur te zbatoje standartin SKK 11 per sa i perket njohjes se Tatim fitimit te shtyre.

b) Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe/ose nese ka humbje te renies se vleres. Te tilla kosto perfshijne koston e zevendesimit te nje pjese te aktiveve afatgjata materiale dhe kostove te huase per projektet afatgjata nese plotesohen kriteret e njohjes. Kur pjese te rendesishme te aktiveve afatgjata materiale nevojiten te zevendesohen ne intervale, Shoqeria i nje keto pjese si aktive te vecanta me vlere te dobishme specifike dhe i zhvlereson ato ne perputhje me rrethanat. Ne te njejten menyre, kur kryhet nje inspektim i madh, kosto e tij njihet ne vleren e mbartur te aktivitet afatgjate material si nje zevendesim nese plotesohet kriteri i njohjes. Te gjitha riparimet e tjera dhe koston e mirembajtjes njihen ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin.

Vlera kontabel e aktiveve afatgjata materiale rishikohet per renie ne vlere kur ndryshimet e rrethanave tregojne qe vlera kontabel mund te mos jete e rikuperueshme. N.q.s rrethana te tilla ekzistojne dhe kur vlera kontabel tejkalon vleren neto te realizueshme, aktivet ose njesite gjeneruese te parase do te pakesohen ne vleren e tyre te realizueshme dhe humbjet nga renia e vleres njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi llogaritet me metoden e vleres se mbetur te aktiveve si me poshte:

Paisje informatike	25%
Mjete transporti	20%
Makineri dhe paisje	20%
Paisje zyre	20%

Nje ze i aktiveve afatgjata materiale si dhe ndonje pjese e rendesishme e njohur fillimisht, rregjistrohet me daljen jashte perdorimi te saj ose kur nuk pritet te sigurohen perfitime ekonomike te ardhshme nga perdorimi apo nxjerrja jashte perdorimit. Cdo fitim apo humbje qe realizohet nga dalja jashte perdorimit e aktivitet (llogaritur si ndryshimi ndermjet te hyrave neto nga dalja jashte perdorimit dhe vlera e mbartur e aktivitet) perfshihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivi rregjistrohet.

Vlerat e rikuperueshme e aktivitet, jeta e dobishme dhe metodat e zhvleresimit rishikohen cdo fund viti financiar dhe rregullohen nese eshte e domosdoshme ne menyre prospektive.



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

c) Aktivet dhe detyrimet financiare*i) Aktivet financiare*

Aktivitet financiare konsistojne teresisht ne llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme dhe jane pasqyruar ne Bilancin Kontabel bazuar ne shumet e faturuara. Kerkesat per t'u arketuuar, te ardhurat e konstatuara dhe llogari te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u arketuuar ne para regjistrohen ne Bilancin Kontabel me kosto te amortizuar. Kostoja e amortizuar e kerkesave per t'u arketuuar afatshkurtra, ne pergjithesi eshte e barabarte me vleren e tyre nominale (minus provizionet e krijuara per renie ne vleren), keshtu qe kerkesat afatshkurtra regjistrohen me vleren e tyre neto te realizueshme (e cila raportohet, per shembull ne nje fature, kontrate ose dokument tjetër). Provizione per llogarite e arketueshme nuk jane llogaritur pasi shoqeria nuk ka shuma per te mbledhur nga klientet.

Crregjistrimi

Nje aktiv financiar (ose ku eshte e mundur pjese e aktivitet financiar apo grup aktivesh financiare te ngjashme) crregjistrohet kur:

- ✓ Te drejtat per te siguruar flukse monetare nga aktivi kane perfunduar
- ✓ Shoqeria ka transferuar te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga aktivi ose ka supozuar nje detyrim per te paguar flukset monetare te mara ne teresi, pa vonesa materiale nje pale te trete nepermjet nje marreveshjeje; dhe ose (a) Shoqeria ka transferuar ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet ose (b) Shoqeria as nuk ka transferuar dhe as ka mbajtiur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet, por ka transferuar kontrollin e aktivitet.

Kur Shoqeria ka transferuar ne menyre thelbesore te drejtat e saj per te siguruar flukse monetare nga nje aktiv ose ka hyre ne nje marreveshje; ajo vlereson nese dhe ne cfare mase ka mbajtiur rreziqet dhe perfitimet e pronesis. Kur as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtiur ne menyre thelbesore te gjitha rreziqet dhe perfitimet e aktivitet, nuk ka transferuar as kontrollin e aktivitet, aktivi do njihet ne masen e perfshirjes se vazhdueshme te Shoqerise ne aktiv. Ne kete rast, Shoqeria njej gjithashtu nje detyrim te lidhur. Aktivi i transferuar dhe detyrimi i lidhur maten ne bazen qe reflekton te drejtat dhe detyrimet qe Shoqeria ka marre persiper. Perfshirja e vazhdueshme qe merr formen e garancise mbi aktivin e transferuar matet me me te voglen ndermjet vleres origjinale te mbartur te aktivitet dhe vleres maksimale te konsiderates qe Shoqeria mund te jete e detyruar te ripaguaje.

ii) Renia ne vlere e aktiveve financiare

Shoqeria vlereson ne cdo date te raportimit, nese ka evidence objektive qe nje aktiv financiar apo grup aktivesh ka pesuar renie vlere. Nje aktiv financiar apo nje grup aktivesh financiare konsiderohet i zhvleresuar vetem nese ka evidence objektive per zhvleresimin si rezultat i nje ose me shume ngjarjeve qe kane ndodhur pas njohjes fillestare te nje aktivitet (nje "ngjarje humbjeje" e ndodhur) dhe kjo ngjarje humbjeje ka pasur ndikim mbi flukset monetare te ardhshme te vleresuara te aktivitet financiar apo grupit te aktiveve financiare dhe qe mund te matet ne menyre te besueshme. Evidence e zhvleresimit mund te perfshije tregues qe debitorët apo grup debitorësh mund te jene duke perjetuar probleme te medha financiare, mospagesa ne kohe te principalit apo interesit, probabiliteti qe ata te kalojne ne falimentim ose nje riorganizim tjeter financiar dhe kur te dhenat e vzhgueshme tregojne se ka nje renie te matshme te flukseve monetare te ardhshme te parashikuara, te tilla si ndryshime ne fusha dhe kushtet ekonomike qe jane ne korrelacion me vonesat.

iii) Detyrimet financiare

Detyrimet financiare konsistojne teresisht ne llogari te pagueshme dhe te tjera te pagueshme jane pasqyruar ne Bilancin Kontabel bazuar ne shumet e faturuara. Detyrimet afatgjata dhe afatshkurtra, jane llogaritur me kosto, dhe jane detajuar me poshte ne shenimin nr. 6.



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

2.2 Permbledhje e politikave te rendesishme kontabel (vazhdim)

d) Mjetet monetare

Mjetet monetare ne Bilancin Kontabel perfshijne mjetet monetare ne banke dhe ne arke ne Leke . Per qellime te pasqyres se flukseve te mjeteve monetare Mjetet monetare perfshijne sa me siper.

e) Detyrimet per sigurimet shoqerore

Shoqeria paguan vetem kontributet per sigurimet e detyrueshme shoqerore qe sigurojne pension per punonjesit. Qeveria shqiptare eshte pergjegjese per caktimin e minimumit te kontributit per sigurimet shoqerore ne Shqiperi sipas nje plani pensioni bazuar ne kontribute. Kontributet e shoqerise ne planin e pensionit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

f) Angazhime dhe detyrime te kushtezuara


Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato jepen ne formen e shenimeve shpjeguese pervec rasteve kur eshte e sigurte qe do kete nje fluks dales burimesh qe mbartin perfitime ekonomike. Nje aktiv i kushtezuar nuk njihet ne pasqyrat financiare por vetem jepet ne formen e shenimeve shpjeguese kur pritet te kete nje fluks hyres perfitimesh ekonomike. Vlera e nje humbje te kushtezuar njihet si provizion nese ka mundesi qe ngjarje te ardhshme do te konfirmohen, nje detyrim do te haset ne daten e Bilancit Kontabel dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes.

g) Transaksionet me palet e lidhura

Pale te lidhura jane ato, kur njera prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influence te rendesishme ne vendimarrjen financiare ose te biznesit te pales tjeter. Per qellim te shpalosjes ne pasqyrat financiare, vetem shoqeria meme do te konsiderohet pale e lidhur.

h) Ngjarje pas dates se bilancit

Ngjarjet pas dates se bilancit qe permbajne informacion shtese per pozicionin e Shoqerise, ne daten e Bilancit Kontabel (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit qe nuk jane ngjarje rregulluese paraqiten te shpalojura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare kur jane materiale. -



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

3 Mjetet monetare

Mjetet monetare ne banke ne monedha te huaja me 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 jane si me poshte:

	2012	2011
Mjete monetare ne banke ne Leke	10,303,497	11,023,997
Mjete monetare ne arke ne Leke	2,191	665,216
	10,305,688	11,689,213

4 Llogari te arketueshme dhe te tjera te arketueshme

	2012	2011
Te drejta ndaj adminstratorit	-	17,000,000
Parapagime shoqerise meme	72,522,248	14,000,000
Parapagim qera	-	270,000
Parapagime tatim qeraje	-	30,000
	72,522,248	31,300,000

5 Aktivet afagjata materiale, neto

	Makineri dhe paisje	Mjete Transporti	Pajisje kompjuterike	Pajisje Zyre	Totali
Kosto historike					
Me 1 Janar 2011	1,279,836	2,040,000	939,663	2,786,706	7,046,205
Shtesa	-	-	34,838	43,800	78,638
Me 31 Dhjetor 2011	1,279,836	2,040,000	974,501	2,830,506	7,124,843
Me 1 Janar 2012	1,279,836	2,040,000	974,501	2,830,506	7,124,843
Shtesa	-	-	189,657	-	189,657
Me 31 Dhjetor 2012	1,279,836	2,040,000	1,164,158	2,830,506	7,314,500
Zhvleresim i akumuluar					
Me 1 Janar 2011	-	(170,000)	(302,135)	(314,955)	(787,090)
Amortizimi per vitin	(255,967)	(374,000)	(160,108)	(498,730)	(1,288,805)
Me 31 Dhjetor 2011	(255,967)	(544,000)	(462,243)	(813,685)	(2,075,895)
Me 1 Janar 2012	(255,967)	(544,000)	(462,243)	(813,685)	(2,075,895)
Amortizimi per vitin	(204,774)	(299,200)	(157,374)	(402,488)	(1,063,836)
Me 31 Dhjetor 2012	(460,741)	(843,200)	(619,617)	(1,216,173)	(3,139,731)
Vlera e mbartur neto					
Me 31 Dhjetor 2011	1,023,869	1,496,000	512,258	2,016,821	5,048,948
Me 31 Dhjetor 2012	819,095	1,196,800	544,541	1,614,333	4,174,769

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SKK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012 dhe 31 Dhjetor 2011.



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

6 Llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime

Llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime me 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 pasqyrojne detyrime ndaj punonjesve dhe organeve shteterore, komisionet e marreveshjes se koncesionit me Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes (METE) dhe detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e materialeve dhe sherbimeve te pa likujduara ne fund te vitit dhe paraqiten si me poshte:

	2012	2011
Parapagime te arketuara	2,702,050	1,503,275
Komisione per Ministrine sipas kontrates (2%eshitjeve)	2,174,218	1,176,015
Detyrime ndaj furnitoreve	1,024,133	-
Tatimi mbi te ardhurat personale	231,640	202,629
Sigurimet shoqerore	142,339	102,192
Te tjera detyrime	532,003	-
	6,806,383	2,984,111

Parapagimet e arketuara jane shumet neto te arketuar nga klientet, (kryesisht notere dhe banka) te cilat nuk jane maturuar ne daten e bilancit.

Komisionet per ministrine eshte vlera e komisionit llogaritur 2% ne baze te te ardhurave te vitit perkates sipas kontrates se koncesionit ndermjet shoqerise dhe METE.

7 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi eshte llogaritur mbi fitimin e tatueshem ne bazen 10%. Tatimi mbi fitimin eshte me 31 dhjetor 2012 618,359 Leke (2011: 3,873,496 Leke)

8 Kapitali aksionar


Kapitali i Shoqerise perbehet nga kapitali themeltar, rezervat ligjore dhe fitimet e pashperndara. Ne perputhje me aktet e Shoqerise, kapitali themeltar eshte 6,200,000 Leke, i cili ka ardhur nga kapitali themeltar ne momentin e krijimit prej 100,000 leke dhe rritja e kapitalit prej 6,100,000 gjate vitit 2011 nga fitimet e pashperndara. (2010: 100,000 Leke). Struktura e kapitalit eshte si vijon:

	Ne Leke	2012 In %	Ne Leke	2011 In %
ROEN Shpk	6,200,000	100%	6,200,000	100%
Gjendja ne fund te vitit	6,200,000	100%	6,200,000	100%

Rezervat ligjore jane krijuar ne perputhje me ligjet per shoqerite tregtare dhe rregulloret ne lidhje me shperndarjen e fitimit ne vitin 2009 ne masen 10% te kapitalit themeltar. Fitimet e pashperndara perfshijne fitimet e krijuara nder vite dhe qe nuk i jane shperndare ortakeve duke u mbajtur ne Shoqeri per zhvillimin e metejshem te aktivitetit.

9 Totali i te ardhurave

Te ardhurat perbehen nga shitjet e krijuara gjate vitit per sherbimet e kryera ne baze te Regjistrimit te Barreve Siguruese kundrejt notereve, bankave dhe klienteve te ndryshem. Te ardhurat nga shitjet jane me 31 dhjetor 2012 108,710,878 Leke (2011: 58,800,748 Leke)



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

10 Shpenzime personeli

	2012	2011
Pagat bruto	14,156,741	10,778,594
Kontribute te sigurimeve shoqerore	993,534	641,193
	15,150,275	11,419,787

11 Te tjera shpenzime

	2012	2011
Qera	3,600,000	3,251,700
Komisioni per ministrine, koncesioni	2,174,218	1,176,015
Energji , karburant uje	1,371,237	806,205
Mirembajtje dhe riparime	295,789	739,625
Te tjera shpenzime operative	2,187,160	697,758
Nentrajtime te pergjithshme, Sherbime nga te tretet, konsulence fiskale e ligjore etj	1,000,000	207,241
Telefon	93,449	121,879
Sherbime bankare	54,279	102,954
Sigurim, garanci kontrate	14,604	66,485
Taksa dhe tarifa vendore	15,120	45,195
Kliente shuma te pa arketuara	181,722	-
	10,987,577	7,215,057

12 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin sa me poshte:

	2012	2011
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual	8,196,113	3,893,497
	8,196,113	3,893,497

Rikonsilimi i normes efektive te takses per shpenzimin e tatimit mbi fitimin ne pasqyren e te ardhurave gjithepershiresë pershkruhet ne detaje si me poshte:

	Norma	2012 Shuma	Norma	2011 Shuma
Fitimi para tatimit mbi fitimin				
Tatimi mbi fitimin duke perdorur normen vendase te taksave te Shoqerise mbi fitimin kontabel:	10%	8,151,445	10%	3,881,442
Plus tatimin mbi shpenzimet e panjohura	0.3%	44,668	3%	12,055
Totali	10.3%	8,196,113	13%	3,893,497

13 Transaksionet me palet e lidhura

Shoqeria ne daten e pasqyrave financiare nuk ka transaksione me pale te lidhura pervec shumave te depozituara prane shoqerise meme gjate vitit 2012 prej 72,522,248 Leke dhe dividendit te shperndare tek shoqeria meme ne shumen 34,920,927 Leke gjate vitit 2012 ne baze te Vendimit te Asamblese te shoqerise meme me date. 29/06/2012 .



Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare (vazhdim)

14 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Ceshtje gjyqesore

Me 31 Dhjetor 2012 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqerise nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012. Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare. Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

Shpenzime kapitale

Nuk ka angazhime kontraktuale per shpenzime kapitale ne te ardhmen

15 Ngjarjet pas dates se bilancit kontabel

Me 31 Dhjetor 2012 ne daten e pasqyrave financiare dhe deri ne daten e aprovimit te tyre nuk ka ngjarje rregulluese te reflektuara ne pasqyrat financiare ose ngjarje qe jane materialisht te rendesishme per te paraqitur ne keto pasqyra.

